



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 268, datë 07.08.2020

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE LIGJORE
TË KANDIDIMIT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN E LARTË, PËR KANDIDATËT
NGA RADHËT E GJYQTARËVE, PËR POZICIONET E LIRA TË SHPALLURA
ME VENDIMET NR.84 DHE NR.87, DATË 26.02.2020, SI DHE VENDIMET
NR.241, NR.242, NR.243, NR.244 DHE NR.245, DATË 09.07.2020,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 136 dhe 147/a, pika 1, shkronjat “c” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85, pikat 2 e 3 dhe nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, si dhe në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020 (në fushat e të drejtës administrative dhe të së drejtës civile), me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës penale), si dhe me Vendimin nr.245, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës administrative), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

- | | |
|--|-------------------------------|
| 1. Për kandidaten znj. Arbena Ahmeti | - relator znj. Marçela Shehu; |
| 2. Për kandidatin z. Artur Kalaja | - relator z. Ilir Toska; |
| 3. Për kandidatin z. Asim Vokshi | - relator z. Ilir Toska; |
| 4. Për kandidaten znj. Elona Toro | - relator znj. Marçela Shehu; |
| 5. Për kandidaten znj. Etleva Temo | - relator z. Ilir Toska; |
| 6. Për kandidaten znj. Iliriana Olldashi | - relator z. Ilir Toska; |
| 7. Për kandidaten znj. Klodiana Gjyzari | - relator znj. Marçela Shehu; |
| 8. Për kandidaten znj. Mariana Shegani | - relator znj. Marçela Shehu; |
| 9. Për kandidaten znj. Nertina Kosova | - relator znj. Marçela Shehu; |
| 10. Për kandidatin z. Sokol Binaj | - relator z. Alban Toro; |
| 11. Për kandidatin z. Sandër Simoni | - relator z. Alban Toro; |

3. Afati i dorëzimit nga kandidatët të deklaratës së pasurisë është deri më datë 11.09.2020.
4. Për kandidatët znj{...}, znj{...}, znj. {...}, z{...}, znj. {...} dhe z{...}, të cilët kanë kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë ose në gjykatat e apelit të juridiksionit të posaçëm, procedurat e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimet e tyre për një ose disa nga pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020, me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243, nr.244, dhe nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
5. Mospërfshirjen e aplikuesit z{...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për katër pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020 dhe me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243, nr.244 dhe nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira në proces.
6. Mospërfshirjen e aplikueses znj. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira në proces.
7. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura respektivisht me Vendimin nr.87, datë 26.02.2020 dhe Vendimet nr.241, dhe nr.243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj{...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këto pozicione më datë 05.08.2020.
8. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr.242, dhe nr.243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj{...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këto pozicione më datë 04.08.2020.
9. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimin nr.84, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj{...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këto pozicione më datë 05.08.2020.
10. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr.87, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr.243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këto pozicione më datë 05.08.2020.
11. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur

me Vendimin nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion më datë 05.08.2020.

12. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr.84, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion më datë 03.07.2020.
13. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr.241, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion më datë 05.08.2020.
14. Disponimi sipas pikave 5 dhe 6, të këtij vendimi, u njoftohen aplikuesve z. {...} dhe znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
15. Aplikuesit z {...} dhe znj. {...} kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit respektivisht të pikave 5 dhe 6, të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR